




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUĐSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.46/2024
Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 5 të Rregullores nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet Komisioni për rekrutim të gjyqtarëve në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, në përbërjen si në vijim:
 1. Albert Zogaj, kryesues i KGJK-së / kryetar i komisionit;
 2. Fejzullah Rexhepi, kryetar i Gjykatës Supreme / anëtar i komisionit;
 3. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së/ anëtar i komisionit;
 4. Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/ anëtar i komisionit;
 5. Valbona Musliu-Selimaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare e komisionit;
 6. Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së / anëtar rezervë i komisionit.
 7. Ivana Milenković, gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega në Shtërpçë /anëtare rezervë e komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 22 shkurt 2024, ka shpallur konkurs për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.

Këshilli në takimin 321-të, ka themeluar Komisionin për Rekrutim i cili është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së rekrutimit, përzgjedhjes preliminare, vlerësimit, përpilimit dhe dërgimit të listës përfundimtare të kandidatëve të propozuar në Këshill, konform nenit 5 të Rregullores nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve. Nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit

